



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:049152

Datë: 26.06.2020

Numri i dokumentit: 00992643

PKR.nr.56/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. Z. nga fshati C. i E. , Komuna D. , për shkak të veprës penale të dhunimit të mbetur në tentativë nga neni 227 par.4 pika 4.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda, PP/L.nr.31/2020 të datës 05.06.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Agron Galani, të akuzuarit B. Z. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av.Gani Kelmendi, si dhe palët e dëmtuara F. T.dhe Z. V.me datë 22.06.2020 mori dhe shpalli si dhe me datë 26.06.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. Z. i lindur me datë, në fshatin C. i E. , Komuna D. , ku edhe jeton, i biri i A. dhe i nënës L. e gjinisë D. ka të krye shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, bujk, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 30.04.2020 e tutje.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më datë, rreth orës minuta në rrugën R. të fshatit P., në afërsi prej 50 metrave nga Sh. e P., pa pëlqimin e të dëmtuarave F. T.dhe Z. V.me përdorimin e forcës ka tentuar që të kryej aktin seksual ndaj të dëmtuarave në atë mënyrë që pasi i pandehuri kishte vërejtur të dëmtuarat të cilat ishin duke ecur në këmbë në drejtim të fshatit P., i pandehuri pasi del nga ara në rrugë i ofrohet të dëmtuarave dhe zhvesh pantallonat deri nën Gjunjë duke nxjerr organin gjenital-penisin dhe i ofrohet të dëmtuarave dhe atë fillimisht të dëmtuarës F. T. duke e kapur të njëjtën me duar për koke dhe duke ia ofruar kokën tek penisi i drejtohet të njëjtës me fjalë, urdhëruese thithma se nuk është kurrgjë, dhe pasi e dëmtuara fillon të bërtas duke i thënë te dëmtuarit, të pafsha qyqe a në ketë ditë koke ardhur, pastaj e shtynë të pandehurin me të dy duart dhe e godet me shuplakë për çka i pandehuri e kap të dëmtuarën Fakte me duar për të dy krahët duke e përplasur për toke e pastaj niset në drejtim të dëmtuarës Z. V.të cilën fillimisht e shtynë duke e hedhur në kanal jashtë rrugës dhe pastaj hyp mbi të dëmtuarën duke iu drejtuar me fjalët, kape thithma penisin se nuk është kurrgjë, mirëpo në atë moment e dëmtuara Z. e kap për fyti të pandehurin dhe me një guri e godet në kokë dhe në atë moment edhe e dëmtuara F. e godet me guri në kokë për çka i pandehuri largohet prej Z. s dhe prapë e sulmon të dëmtuarën F. duke e shtrirë për toke dhe pasi e dëmtuara Z. ngritët në këmbë shikon ndonjë mjetë me të cilin do ta

godiste të pandehurin, i pandehuri nisat në drejtim të Z. s e cila fillon të vrapoj, mirëpo në atë moment e dëmtuara F. bërtet duke thënë ja po vjen Policia dhe kur i pandehuri dëgjon këto fjalë largohet nga vendi i ngjarjes.

-Me çka ka kryer veprën penale të dhunimit e mbetur në tentativë nga neni 227 par.4 pika 4.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 28 të KPRK-së,

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7,8,38,40, 42, 69,70,71,72 të KPRK-së, nenit 227 par 4, pika 4.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 28 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin B. Z. e

G J Y K O N

Të akuzuarin B. Z. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite e tre (3) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 30.04.2020 e gjerë me datë 22.06.2020

Obligohet i akuzuari i lartcekur që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 70€ (shtatëdhjetë euro), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 50€ (pesëdhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Palët e dëmtuara F. T.nga fshati P., Komuna D. dhe Z. V.nga fshati R. , Komuna e P. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.31/2020 të datës 05.06.2020, kundër të akuzuarit B. Z. nga fshati C. i E. , Komuna D. , për shkak të veprës penale të dhunimit të mbetur në tentativë nga neni 227 par.4 pika 2.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.22.06.2020 ku prokurori para se të lexoj aktakuzën ka bërë përmirësimin e aktakuzës sa i përket kualifikimit juridik ashtu që kualifikimi duhet të jetë “Me çka ka kryer veprën penale të dhunimit e mbetur në tentativë nga neni 227 par.4 pika 4.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 28 të KPRK-së” ngase gabimisht është shënuar pika 2.2 në vend të pikës 4.2 të cekur si më parë. Po ashtu prokurori ka bërë edhe përmirësimin e datës së lindjes së të akuzuarit që duhet të jetë dt., siç rrjedh nga letërnjoftimi i të akuzuarit. Këto përmirësime prokurori i bënë pasi që të njëjtat janë lëshuar si gabime teknike gjatë përpilimit të aktakuzës.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/I.nr.31/2020 të datës 05.06.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar: se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e Gjykatës dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndien keqardhje, është penduar shumë nuk do ta përsërit më.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se propozon që të aprovohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, duke pas parasysh se i akuzuari e ka pranuar edhe në procedurën para penale, në procedurën hetimore i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, si dhe duke pas parasysh faktin se ky pranim fajësie mbështet edhe në deklaratat e të dëmtuarave dëshmitarëve F. T.dhe Z. V. si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Gani Kelmendi ka deklaruar se pajtohet me deklaratën e të mbrojturit të tij i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë dhe kërkoi nga Gjykata që të aprovoj fajësinë ndaj klientit të tij. Meqenëse është seancë fillestarë dhe nuk ka fjalë përfundimtare atëherë deklaroi se nëse Gjykata e aprovon fajësinë ti ketë parasysh këto rrethana, i mbrojturi i tij pranë organeve policore, në prokurori dhe në seancë gjyqësore e pranon fajësinë duke deklaruar se e ka kryer veprën penale e cila atakohet i njëjti sot në Gjykatë publikisht kërkon falje për veprimet e tij të cilat i ka shkaktuar këtu të dëmtuarave me të vërtetë ndjen keqardhje. I mbrojturi i tij nuk është ballafaquar me organet gjyqësore dhe nuk ka njohuri çka janë organet gjyqësore. I njëjti ka probleme familjare ngase në moshën e re ka mbetur pa baba dhe nënën dhe lënë në mëshirën e axhallarëve. Për të gjitha këto edhe një herë shpreh keqardhje për veprimet e tij e gjithashtu Gjykata duhet të marrë për bazë deklaratën e të dëmtuarave të cilat në prokurorinë e shtetit kanë deklaruar se nuk bashkëngjiten ndjekjes penale ngase familjarisht janë pajtuar. Kërkon nga ana e Gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij të ndërpritet masa e paraburgimit, ngase kanë pushuar të gjitha arsyet për mbajtje të metutjeshme. Nga të gjitha këto kërkon nga Gjykata që ti ketë parasysh dhe klineti i tij ti shqiptohet një dënim i arsyeshëm dhe ky dënim do ti ndikoi në të ardhmen.

Mbrojtësja e viktimave ka deklaruar se pajtohet me deklarimin e prokurorit për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, njëherit deklaroi se me të dëmtuarat është konsultuar dhe i ka këshilluar se kanë të drejtë për kompensim dëmi, meqenëse janë këto kërkoi që të deklarohen vet.

Të dëmtuarat F. T.dhe Z. V.nuk patën asgjë për të deklaruar në fjalën përfundimtare.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi ai ishte në gjendje për të kuptuar të drejtat e tij dhe natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe nuk kishte ndonjë rrethanë që do të ndikonte në zhvillimin e procedurës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: shënimi zyrtar i përpiluar me datë 30.04.2020 nga ana e hetuesve të S.P në Deçan. , Nestor Neziraj dhe Shkelzen Dautaj, foto e të pandehurit të bëra në S.P. në Deçan. me datë 30.04.2020, fotot e rrobave të pandehurit të datës 30.04.2020 të lëna pas kryerjes së veprës në traktorin e tij, raporti mjekësor për të dëmtuarën F. T.të Q.K.M.F. në Deçan. e datës 30.04.2020 përpiluar nga DR Xhavit Rabushaj me nr. protokoli 6996, fotografit e të dëmtuarës F. T. e dt. 30.04.2020, raporti mjekësor për të dëmtuarën Z. T. të Q.K.M.F në Deçan. e dt. 30.04.2020 të përpiluar nga dr.Xhavit Rabushaj me nr. protokoli 6995, fotografit e të dëmtuarës F. T.e datës 30.04.2020,

vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht, një palë puma nga i pandehuri e dt. 30.04.2020 nën nr. 2020-DC-130, raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. dosje 2020-DTK-29 e dt. 30.04.2020, fotoalbumi nga vendi i ngjarjes me nr. 2020-DC-130 e dt. 30.04.2020, gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 të KPK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e ka pranuar fajësinë, pati sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, kërkon falje dhe premtoj se nuk do të përsërit veprime të tilla, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të cekura si më lartë, kualifikimin e veprës së mbetur në tentativë, të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPK-së e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Konform nenit 463 të KPPK-së, gjykata e udhëzoi palët e dëmtuara F. T.nga fshati P., Komuna D. dhe Z. V.nga fshati R. , Komuna e P. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,
2020:049152, 26.06.2020**

Kryetarja e turpit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.